



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG**

---

Numri i lëndës: 2022:082106

Datë: 05.08.2022

Numri i dokumentit: 03303642

**PPP.nr.15/2022**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG**, si përmbarrimore e përberë nga Gjyqtari individual Blerim Istrefi, në çështjen juridike të kreditorit F.M nga fshati V. K.Istog, kundër debitorit V.H B.I me nr te biznesit ...me emër tregtar Restaurant F. me seli në Pejë, me përfaqësues V.H nga fsh. V. K.Istog, për shkak të borxhit në shumë prej 1,499.00€, pas prapësimit të ushtruar nga ana e debitorit, me dt: 13.04.2022 kundër urdhrit mbi lejimin e përmbarrimit, gjykata jashtë seance me dt.05.08.2022 nxjerr këtë

**A K T V E N D I M**

**HEDHET POSHTË** prapësimi i debitorit: V.H B.I me nr te biznesit ...me emër tregtar Restaurant F. me seli në Pejë, me përfaqësues V.H nga fsh. V. K.Istog, ushtruar kundër urdhrit mbi lejimin e përmbarrimit P.nr.33/2022 të dt.31.03.2023 për shkak të borxhit në shumë prej 1,499..00 €, si i PA AFATSHËM.

**A r s y e t i m**

Kreditori, F.M nga fshati V. K.Istog ka ushtruar propozimin për përmbarrim tek përmbarruesi privat, me të cilin ka kërkuar që të lejohet përmbarrimi ndaj debitorit: V.H B.I me nr te biznesit ...me emër tregtar Restaurant F. me seli në Pejë, me përfaqësues V.H nga fsh. V. K.Istog, si në shkresat e lëndës, për borxh në shumë prej 1,499.54 €, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore, të gjitha këto në afat 7 ditor nga pranimi i urdhrit, në të kundërtën të bëhet bllokimi i llogarive bankare të debitorit, sekuestrimi regjistrimi dhe shitja e sendeve te luajtshme dhe te paluajtshme, e shuma e mjeteve të transferohet në llogari te kreditorit, të gjitha të specifikua në propozimin për përmbarrim të datës 31.03.2022.

Përmbarruesi privat me urdhër P.nr.33/2022 të dt.31.03.2022 e ka lejuar propozimin për përmbarrim.

Pas lejimit të përmbarrimit me urdhër përmbarrimor, të njëjtin përmbarruesi privat ja ka dorëzuar debitorit të cilin e ka pranuar me datë 31.03.2022 me

paralajmërimin se pala e pakënaqur ka të drejt të paraqes prapsim në afat 7 ditor nga dita e pranimit të të njëjtit.

Debitori, V.H B.I me nr te biznesit ...me emër tregtar Restaurant F. me seli në Pejë, me përfaqësues V.H nga fsh. V. K.Istog, ka ushtruar prapsim me dt: 13.04.2022 kundër urdhrit për përmbarim P.nr.33/2022 të dt.31.03.2022, me të cilën është lejuar përmbarimi sipas propozimit të kreditorit: F.M nga fshati V. K.Istog.

Nga shkresat e lëndës, konstatohet se debitori, nuk ka vepruar brenda afatit ligjor të përcaktuar për paraqitjen e prapsmit kundër urdhrit mbi lejimin e përmbarimit, andaj gjykata, bazuar ne nenin 70 te Ligjit të Procedurës Përmbarimore i cili thotë citoi “Prapësimi duhet ti paraqitet gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbarues ose urdhrit përmbarues” e në rastin konkret debitori Komuna e Istogut e ka pranuar propozimin për përmbarim të lejuar me urdhër me datë 31.03.2022 dhe afati ka filluar të ecë nga data 01.04.2022 ndërsa prapësimin e ka parashtruar me datë 13.04.2022, e nga pranimi i propozimit të përmbarimit e deri me ditën e paraqitjes së prapësimit kanë kaluar 13 ditë, e në rastin konkret afati i fundit për ngritjen e prapësimit ka qenë data 07.04.2022, ashtu që prapësimi i debitorit konsiderohet si I PA AFATSHËM.

Andaj, nga të lartcekurat e duke u bazuar në nenin 70, 73.3 të LPP-së (Ligjit të Procedurës Përmbarimore), u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG**  
**PPP.nr.15/2022, dt. 05.08.2022**

**GJYQTARI**  
Blerim Istrefi

**UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate.